

SHTYPI I SHKRUAR DHE LETËRSIA SHQIPE (ASPEKTE KRAHASUESE MES PERIODIKËVE)

Ermira YMERAJ, Klodeta DIBRA

ermira.ymeraj@unishk.edu.al, klodeta.dibra@unitir.edu.al

Abstrakt

Ky punim trajton rolin e shtypit të shkruar në promovimin e letërsisë shqipe në periudha të ndryshme historike, përmes një analize krahasuese të disa prej periodikëve kryesorë që kanë fillimet e tyre në vitet '30 të shekullit të kaluar deri në ditët e sotme. Përmes metodës së analizës tekstuale dhe kritike, theksohet ndikimi që revistat letrare si “Përpyjekja shqiptare”, “Shkëndija”, “Shejzat”, “Kritika”, “Nëntori” dhe “ExLibris” kanë pasur në formimin e mendimit letrar, kulturor dhe kombëtar. Studimi nxjerr në dukje mënyrën se si këto periodikë kanë mundur të ndikojnë në shijen e leximit, frymëzimin e shkrimtarëve dhe ndërgjegjësimin kulturor të lexuesve.

Fjalë kyçe: Shtypi i shkruar, letërsia shqipe, periodikët, kritika letrare, promovimi letrar, analiza krahasuese

1. Hyrje

Shtypi i shkruar është një dritare e rëndësishme për të promovuar letërsinë, për të ndikuar te lexuesi dhe për të dokumentuar zhvillimet që ndodhin brenda historisë së letërsisë. Këto përpjekje konkretizohen përmes qëllimeve të botuesve në përmbajtjen e revistave të tyre. Ata shprehin se: “Shtypi është barometri që mat atmosferën e jetës së një vëndi, ai shqyrton e njeh të rrahurat e dejeve të gjallnisë së një populli; prandaj shtypi i jonë thekshëm u prek prej kësaj faze të jetës, edhe, ku sheshas, ku tërthoras çoi zërin, e fuqishëm qiti kushtimin për krijesën e një atmosfere mendore të shëndoshë, për ngrehjen e një Shqipërie me zakone të shenjta, me vlera njerzore, ndër baza shpirtnore etj.” (Çika, 1935).

Me këtë mision dhe shtypi shqiptar ka luajtur një rol themelor në promovimin dhe zhvillimin e letërsisë shqipe. Ai ka vepruar si një medium ndërmjet shkrimtarit dhe lexuesit, duke ndikuar në mënyrën se si perceptohet dhe zhvillohet letërsia në nivel kombëtar. Ky studim synon të analizojë ndikimin e revistave letrare në këtë proces, duke u përqendruar në disa pyetje kërkimore:

- A kultivojnë këto revista shijen e leximit?
- A e dominojnë opinionin publik me kulturë dhe ndërgjegjësim të ri kombëtar?
- A frymëzojnë lëvizje të shkrimtarët?

2. Metodologjia

Studimi bazohet në analizën tekstore, krahasuese e përshkruese të përmbajtjes së disa revistave me karakter kulturor.

Terreni i kërkimit shkencor do të kufizohet tek disa tituj periodikësh kombëtarë para dhe pas '90-ës. Sot në Shqipëri ka fare pak revista letrare, që japin informacion me subjekte të zgjedhura për lexuesin e synuar. Arsyeja e përzgjedhjes së disa titujve e kemi nisur nga plotësimi i disa kriterëve që kemi marrë përsipër t'i trajtojmë në kërkim:

- Furnizojnë me të dhëna kërkimin tonë;
- Kanë një strukturë të pranueshme të organizimit të brendshëm për promovimin e letërsisë;
- Botojnë e prezantojnë letërsinë sipas llojeve të ndryshme të lëvimit;

- Prezantojnë profile me autorë të njohur e të rinj, të përkthyer dhe të pa përkthyer në skenën letrare;
- Prezantojnë diversitetin e identiteteve letrare dhe krijuese përmes kritikës letrare;
- Publikojnë recensime, që na njohin me formimin dhe cilësinë e veprave letrare dhe nxisin debate konstruktive;
- Publikojnë antologji apo fragmente nga veprat e autorëve që ndihmon në ruajtjen dhe përhapjen e trashëgimisë letrare;
- Publikojnë intervista me autorë si perspektivë e procesit krijues;
- Organizojnë platforma për zbulimin e autorëve të rinj.

Shtypi me qëndrimet e tij ndaj letërsisë nisur nga cilësia e materialeve që ekspozon lidhet ngushtësisht me:

- periudhën historike që kalon vendi;
- mendësinë dhe kulturën e botuesit për të krijuar një ligjërim të caktuar;
- ndërtimin e një kritike letrare të shëndoshë;
- promovimin e krijimtarisë artistike të vendit të tyre.

3. Rezultatet

Periodikët që kemi marrë në shqyrtim përkojnë me këto periudha historike:

- 1936 - 1939 (shtypi në monarki);
- 1939 - 1945 (shtypi gjatë luftës së dytë botërore);
- 1945 - 1990 (shtypi në regjimin komunist);
- 1990 - 2023 (shtypi i post komunizmit).

3.1. *“Përpyjekja Shqiptare” (1936–1939)*: Drejtuar nga Branko Merxhani, e orientuar drejt ndërtimit të një doktrine nacionaliste-demokrate. Rubrika të shumta me karakter kulturor dhe letrar, për lexues të përzgjedhur.

3.2. *“Shkëndija” (1940–1943)*: Themeluar nga Ernest Koliqi. Rëndësi e veçantë i kushtohet promovimit të gjuhës, përkthimeve dhe mendimit kritik. Përfaqëson një përpyekje gjuhësore dhe kulturore.

3.3. *“Kritika” (1944)*: Revistë e drejtuar nga Arshi Pipa, që në focus ka kritikën letrare. E strukturuar në dy pjesë, me recensione dhe artikuj origjinalë. Përfaqëson një moment të rëndësishëm të mendimit letrar shqiptar.

3.4. *“Shejzat” (1957–1978; pas ’90-ës)*: Drejtuar nga Ernest Koliqi dhe më vonë Ardian Ndreca. Një monument i kulturës letrare në mërgatë. Vazhdimësi në vizionin kritik dhe promovimin e mendimit të lirë letrar

3.5. *“Nëntori” (1954–1990)*: Organ i kontrolluar nga regjimi komunist. Në funksion të propagandës, përfaqëson kufizimet e mendimit letrar të kohës, por edhe një arkiv të rëndësishëm të soc-realizmit

3.6. *“ExLibris” (pas ’90-ës)*: E themeluar nga Bujar Hudhri, një gazetë e përjavshme me përmbajtje gjithëpërfshirëse, që promovon letërsinë shqiptare dhe përkthimet. Ofron një tribunë për mendimin letrar dhe bashkëkohor.

4. Diskutimi

Branko Merxhani shprehet se:

Një revistë e përmuajshme nuk është një gazetë. Është një libër i vogël që botohet vazhdimisht 12 herë në vit. Është një vepër që ndjek një system dhe që ka për qëllim të përhapë, të mbrojë një ide. Një nga qëllimet e caktuara ... është të transferojmë në gjuhën shqipe parimet e shkencave ashtu siç janë.¹

Periodiku që ai drejtoi titullohej “Përpyjekja shqiptare”. Nga vetë drejtuesi shihej si vazhdim i një tjetër periodiku quajtur “Demokrati”, përkon me periudhën e monarkisë, në kohëzgjatje 3 vjet, punuan vetëm për kulturën dhe kontribuan për ndërtimin e shijeve letrare drejtuar lexuesit të specializuar. Ishte dritarja ku u prezantuan emrat më me zë të letërsisë dhe kritikës.



“Përpyjekja Shqiptare” (1936 – 1939), vazhdim i “Demokrati”, dalë në Gjirokastër, më 1928.
Drejtör: Branko Merxhani


Vendos në qendër kulturën:	“Politikë s’ka! Vetëm Kulturë!” Sintezë që krijon terrenin për ndjekje të autorit.
Produkti	E përmuajshme.
Zonat e lexuesit	Lexuesit të specializuar.
Rubrikat	Trajtesa kulturore si: <i>Filozofi, Histori, Ekonomi Kombtare, Albanologji, Arsim, Demografi, Shënime kritike gjuhësore, Letërsi</i> (vjersha, novela, trajtime letrare origjinale dhe të përkthyer), <i>Çështja e gjuhës</i> <i>Tre përkthime shqipe</i> <i>Silhouette shqiptare</i> <i>Problemat e mëdha t’epokës</i> (rindërtimi i Ballkanit) <i>Bisedime Akademike</i> , (kulturë komunikimi) <i>Arshivë</i> (monografi dhe dokumenta) Muaji shqiptar (pasqyrë e jetës mendore dhe kulturore) <i>Muaji ndërkombëtar</i> (probleme të lindjes dhe perëndimit) <i>Bibliografi shqiptare dhe e huaj</i> <i>Pedagogji, Sociologji, Kulturë fizike</i> <i>Libri i muajit</i> (analizë dhe fragmente) <i>Jeta dhe librat</i> ² . Përkthime ³ .
Autorët që trajton	Lumo Skendo, Mehdi Frashëri, Aleksandër Xhuvani, Lasgush Poradeci, Emilio Durhneim, Përkthyes: Ernest Koliqi, Andrea

¹ Merxhani, Branko., “Përpyjekja Shqiptare”, revistë e përmuajshme kulturore. Viti 1, Tiranë, tetor 1936, nr. 1. f.3.

² Artikulli “Tri revista shqiptare”, ndër të tjera thuhet: Detyrë e një reviste shqiptare sot, është të zhvillojë një përpjekje sistematike për të kontribuar, sa më mirë dhe sa më shpejt, në procesin e zorshtëm të formimit mendor të klasës së mësuar dhe të gjallë të Kombit.... Duhet studiuar jeta shqiptare në gjitha format dhe dukjet e saj. f. 59.

³ Athur Mills, “The yellow Dragon”, përkthyer shqip nga Sadi Pejani. f. 61.

	Varfi (Hisponik), Anton Logoreci (Politkolog), Petro Marko, Ethem Haxhiademi ⁴ , Krist Maloku, Kostaq Çipo.
Drejtuesit	Një drejtues, çfarë shmang mospajtimet midis pronarëve në kurriz të lirisë editoriale.
Qëllimi	Lëvizje mendore për formimin e një doktrine nacionaliste-demokrate shqiptare të përshtatëshme me nevojat reale të kombit dhe sipas mundësisë s'epokës s'onë. krijimi i "Neo-Shqiptarismës".
Hulumtimi	Hetim kritik, historik, filozofik i zhanreve letrare.



Shkëndija” e Ernest Koliqit. Numri i parë doli në korrik të 1940 deri më 1943, drejtohej nga Selahudin Toto, dhe pas një viti nga vetë Koliqi. Në programin e revistës “Shkëndija”⁵, citohet:

1. *Gërmim i vijueshëm në shpirtin shqiptar të pa-rmuem;*
2. *Lartësim i instiktevët ma të shëndosha të kombit;*
3. *Përpjekje gjuhësore në mënyrë qi zhvillimet e idevet të reja t’u japin hov të ri e virtyt të fuqishëm shprehjeje fjalvet të gjuhës s’onë së vjetër.*

Periodiku “Shkëndija” pati 3 vite jetë si revistë e pavarur e përmuajshme, në sasi e cilësi përbën një trashëgimi të çmuar. Aty gjetën përfaqësi autorë të kohës përkatëse, autorë të traditës nga vendi e bota, përkthime, polemika, debate, qëmtime e prurje të reja nga mendimi modern teorik e letrar, nga proza e shkurtër, nga poezia; mbi të gjitha kishim një ekspozë të pasur të mendimit kritik. Nisur nga politika editoriale⁶, pohojmë se në tregun shqiptar ky periodik promovoi letërsi, iu përkushtua kërkimit shkencor, ndërveprues dhe komunikues me lexuesin në nivel akademik.



“Kritika” e Arshi Pipës
1944
(katër numra)

⁴ “Diomedji, tragjedi me pesë akte, Tiranë 1936. E. Haxhiademi. f. 62.

⁵ Koliqi, Ernest: “Shkëndija”. 1/1940. nr. 1. f. 6.

⁶ Kruja, Mustafa: “Shkëndija”. 1/1940. nr. 1. f. 8. Shih: Botimi i njëj së përkohëshmeje qi merret me art e me letërsi në këto orë t’etheshme në të cilat po përshkohet Europa, ka me i u dukun ndokujt një vepër guximtare. Shqiptari, tue kundruë çfaqjet e jetës së re, ka me ndie nevojën t’a interpretojë këtë nëpërmjet shkrimtarvet të vet, në një mënyrë krejt të veten. ... Ka me dishrue t’a lirojë në letërsi e në art shpirtin e vet të ngarkuem me barrën e randë t’arratijavet mijëvjeçare.

Një revistë e rëndësishme letrare e shekullit XX, ishte dhe “Kritika”, e themeluar në vitin 1944. Pavarësisht kohëzgjatjes së shkurtër, ajo luajti një rol themelor në promovimin dhe përhapjen e letërsisë shqipe, duke botuar vepra të shkrimtarëve shqiptarë të shfaqur dhe të afirmuar, duke recensuar libra, duke intervistuar shkrimtarë dhe botuar vepra origjinale letrare. Kjo u ka mundësuar shkrimtarëve shqiptarë të arrijnë një audiencë më të gjerë dhe t’i bëjnë veprat e tyre të njohura përtej kontekstit letrar tradicional.

Nga tipologjia, “Kritika” e Arshi Pipës përmban shkrimet kritike që i përkasin gjithë spektrit të njohur të kritikës si: kritikë stilistike; kritikë estetike; kritikë e përshtypjes; kritikë biografike, kritikë filozofike e recensa. Të tillë artikuj te *Kritika*, hedhin dritë mbi situatën e letërsisë, shpjegojnë mendimin dhe qëndrimin e mbështetur në dijen e kohës.

Vendos në qendër artikuj kritikë që:	Bisedime estetike që pasqyrojnë: a. sensin e shëndoshë b. patriotizmin c. qëndrimin ndaj moralit d. besimin e. autoritetin letrar
Rubrikat	Strukturohet në dy pjesë: pjesa e parë përmban prodhime origjinale e përkthime, pjesa e dytë kritikë që i “prekë” veprat, i “shijon”: “kritikë e shijes”, recensime, jehona kulturore.
Produkti	Del një herë në muaj me 40 faqe.
Zonat e lexuesit	Lexuesin e specializuar.
Autorët që trajton	Arshi Pipa, Pashko Gjeçi, Faik Konica, Mitrush Kuteli, Ndre Mjeda, Zef Serembe, Fan Noli, Selman Riza, Astrit Delvina, Risto Siliçi,
Drejtuesit	Një drejtues shmang mospajtimet midis pronarëve në kurriz të lirisë editoriale.
Qëllimi	<i>Me krijue një tribunë të veçantë për kritikën e letravet¹.</i>
Hulumtimi	Hetim kritik që lidh kulturën letrare me kulturën artistike e shkencore.



Periodiku “Shkëndija”, vijoi me “Shejzat”. Të dy këto periodikë, sot i japin një pamje të gjerë kulturës së medias, veçmas zhvillimeve letrare, problemeve të diskutuara, si çështje të përhershme të çdo kohe e brezi krijuesish e studiuesish, por edhe si çështje specifike, të lidhura ngushtë nga gjendja e kritikës në Shqipëri. Në metodologji, në qasjen teorike, por dhe në vullnetin subjektiv “Shejzat”, (“Le Pleiadi”), është një monument kulture, u botua në vitet 1957 – 1978 (periudha e komunizmit në Shqipëri). Ernest Koliqi, autor e drejtues i dy revistave, në krizën identitare të letërsisë shqipe, botuar në mungesën e lirisë së shtypit për shkak të regjimit

¹ Pipa, Arshi., “Kritikë”, f. 26.


sundues, arriti që në këtë periodik të pasqyrojë çështje letrare me rëndësi për zhvillimin dhe njohjen e letërsisë, pavarësisht modelit të shtypit që ishte në Shqipërinë territoriale dhe modelit të shtypit që ofrohet sot.

Të dy periodikët, i komunikojnë publikut lajme për vepra të reja, për veçori e epërsi, për të arsyetuar tek e fundit përse duhej lexuar e përveçuar libri në fjalë, kritikë e nënllaje të kritikës, që krijojnë një fond të spikatur me autorë e vepra të analizuara, si sintezë e problemeve më të qenësishme të penave të përfshira, profesionalisht të dalluar për lartësinë e çështjeve të shtruara. Në faqet e “Shejzave” të Koliqit lëvrohen të gjitha modelet dhe shkollat kritike, duke prodhuar sot monografi e teza në literaturën albanologjike. “Shejzat” e Koliqit përcjellin qëndrime atdhetare, përdorin teksturë emocionale. Në faqet e periodikut, Koliqi projektonte autorë që kishin pikënisje në historinë e letërsisë dhe shpalos prirje letrare që i drejtohen lexuesit në mërgim. Koliqi si shkrimtar liberal, besonte dukshëm në përkufizimin se,

*“kjo e përkohëshme don të jet tryeza e lirë kuvendi burrnuer, të mbajtur mbrenda caqeve t’urtis e të njerzis. Çdo Shqiptar qi ka një mendim fryt-dhanës për të shfaqun dhe din t’a shfaqti në shqipe të pastër, çdo intelektual qi lakmon të rrahi një çashtje ditunore ase don të paraqesi prodhimet e veta letrare, ka me gjetun vend në këto fletë t’ona, mjaft qi të frymëzohet në xhixhillim të Shejzave, hyllsi vërtytesh arbnore.”*²

Revista e tij duhej të rriste interesin kulturor, gjuhësor dhe politik, dimensionet e reja të së cilës ofrojnë bashkëpunëtorë me të njëjtat ideale, që u japin shkrimeve formën shkak - pasojë.

Në kontekstin e një diktature, roli i revistës kulturore, “Shejza”, që promovonte letërsinë shqipe jashtë, ishte i dobishëm. Kritika e hapur ndaj regjimit, idetë letrare alternative, shprehja e lirë e mendimeve të ndryshme, rritën cilësisht debatin letrar. Kjo revistë e botuar në të njëjtën kohë me diktaturën ishte një medium i përdorur për të përhapur letërsinë, kulturën dhe artin shqiptar jashtë kufijve.



Gjatë viteve 1945 - 1990, shtypi letrar u vu në funksion të plotë të sistemit totalitar, duke e humbur përfundimisht rolin e parë, atë të informimit. Detyra e shtypit gjatë regjimit komunist ishte: *mobilizimi i masave në konsolidimin e shtetit diktatorial*. Ne jemi ndalur te revista letrare “Nëntori”, (1954), me bord editorial të kontrolluar nga qeveria. Revista mohonte misionin e vet për lirinë e shtypit, e kufizuar brenda normave të soc-realizmit, ishte e destinuar t’i nënshtrohej arrogancës diskriminuese të pushtetit popullor ndaj fjalës së lirë. Kulturalisht kufizimet serioze sollën keqinformim të lexuesit dhe imponuan një narrativë të caktuar, duke mbajtur në kontroll informacionin dhe kulturën që prodhohej jashtë, për të ruajtur stabilitetin e regjimit. Letërsia e publikuar në këtë revistë ishte e përzgjedhur, e rregulluar në përputhje me mesazhet e regjimit³.

² “Shejzat” (Le Pleiadi), Vëll. 1. Nr. 1 (1957). f. 2.

³ “Nëntori”, Organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, Revistë e përmuajshme letrare artistike shoqërore politike, nr. 1. viti XXXI i botimit, Janar, 1984. Në përmbajtjen e saj veçojmë: artikuj politikë mbi rolin e revistës “Nëntori”, Kritika letrare artistike që trajton artikuj kritik nën drejtimin letrar të realizmit socialist veçojmë artikullin: Isuf Nelaj: Poezi e kohës së madhe – “Frymëzime na dha koha e Partisë”, antologji me poezi të zgjedhura. Po aty., f. 43. Vijon me Publicistikë, Krijime letrare; Probleme teorike; Studime Folklorike; Letërsi e huaj, Recensione, Letërsi – Art.



“Sot “Shejzat”, të çliueme prej një pjese të barrës që kishin kur lindën s’parit, rikthehen në detyrën me i rezistu antikulturës, asaj qi paraqitet si një stërzgjatje e epokës komuniste që perëndoi pa lavdi por sidomos asaj kallpes që e ka zëvendësue si produkt i pashmangshëm i varfrisë mendore dhe shpirtërore... Për këtë arsye seria e re e “Shejzave” don me u kthy në një tribunë të mendimit shqiptar, dhe dialogu gjallnisht me intelektualë e studiues të arealit ballkanik, e hapur ndaj mendimit kritik, me qëllimin me thadrue metoda të reja hulumtuese në lajmet e ndryshme të kulturës sonë”⁴, citon Ardian Ndrecës.

Rikrijimi e ndjekja e modelit me “Shejzat” e Ardian Ndrecës, e bën këtë të fundit një zë të ndjeshëm në mjedisin tonë kulturor, në qendër të zhvillimeve, debateve, polemikave, por edhe të prurjeve e prirjeve më të reja, nga krijimtaria shkencore, nga mendimi kritik-letrar.

“Shejzat”, janë dy periodikë që para dhe pas 90-ës, nuk kanë ndryshime në format, por kanë modelime dhe rimodelime të reja, kanë hyrje dhe dalje rubrikash, ekspozojnë tema të reja për letërsinë. Nëpërmjet këtyre periodikëve afirmohen një sërë studiuesish, duke iu drejtuar një audience që vështirë se mbërrihet nëpërmjet librave, ato gjetën njëri-tjetrin dhe publikun, jo përherë në harmoni, por përherë në evoluim, me kontestime e befasi estetike, duke hapur faqe të reja në historinë tonë kulturore e artistike. Prof. dr. Hamit Boriçi në citimin e tij për shtypin shprehet se: “shtypi është “udhëheqje e lexuesit në veprimtarinë jetësore”. “Edhe gazeta me “ideale” për pavarësi dhe “asnjanësi”, synon të ushtrojë ndikim në auditorin të cilit i drejtohet. Këtë përpiqet ta realizojë përmes zgjedhjes së informacionit që përcjell, mënyrës së hartimit të lajmit dhe thekseve llogjike”⁵.

Në këtë vijë logjike kemi vëzhguar çdo numër të tyre dhe përmes analizës krahasuese evidentuam dallime në shkrimet që publikojnë, dukuritë që kanë trajtuar, bashkëpunuesit, emrat e të cilëve dje modernizuan dhe zhvilluan letërsinë, ndërsa sot e mbajnë gjallë studimin e saj. “Shejzat” e Ndrecës kanë një tjetër qasje, bazuar në kriteret letrare të çdo artikullshkruesi, në respektimin e vizionit të përcaktuar shkencor, etik, të zbatueshëm për autorët. Ndrecës vijon botimin e Shejzave, udhëhequr nga fryma profetike e triumfit të letërsisë dhe shkencës që e studion atë. *In Memoriam* është rubrikë që vazhdon për të dy profilet e revistave, në trajtesa më të hollësishme mbi figurat e veçanta me rol themeltar në zhvillimet e historisë së letërsisë.

⁴ “Shejzat”, Pleiades, Viti 1, Janar – Qershor 2016, 1-2. *Parathënie*. f. 3.

⁵ Hamit Boriçi, “Fillimet e gazetarisë shqiptare dhe periodizimi i historisë së saj”, Media Shqiptare, AMI, IREX, SOROS, Tiranë, janar mars 1999, f. 97-121.



“Exlibris”, gazetë e përjavshme letrare dhe kulturore, me themelues Bujar Hudhrin, identifikon kauzën e botuesit për të ekspozuar lëvizjet letrare brenda Shqipërisë, duke përfshirë e botuar autorë me një gjuhë retorike, klasike e të hapur, opinione e intervista.

Me qasje më së shumti divulgative, gazeta në fjalë synon të shndërrohet një tribunë e letërsisë shqipe, duke rrokur pothuaj gjithë historinë e saj, që me Gjon Buzukun e deri tek krijuesit më të rinj. Si një gazetë gjithëpërfshirëse e mbarëkombëtare, ExLibris vjen me shkrime, opinione të studjuesve dhe shkrimtarëve më me zë të letërsisë shqipe, intervista me krijues e përkthyes të huaj të letërsisë shqipe, kritikë, recensime, botime në prozë e poezi të autorëve të ndryshëm, studime albanologjike edhe me albanologë të huaj, përkthime nga letërsia e huaj, dhe është e hapur për krijuesit shqiptarë të Shqipërisë, të trojeve shqipfolëse, të arbëreshëve, të krijuesve të së ashtuquajturës diasporë e letërsisë shqipe.

5. Përfundime

Letërsia e promovuar në periodikë është një letërsi cilësore. Të gjithë periodikët që kemi cituar janë të orientuar drejt njohjes të kësaj letërsisë. Ato i kanë kushtuar vëmendje të veçantë përzgjedhjes së veprave dhe autorëve të cilët ofrojnë një vlerë artistike dhe mendimtare. Janë ndalur në ekspozimin e veprave të cilat kanë marrë vlerësim pozitiv nga kritikët e letërsisë ose kanë fituar çmime. Këto periodikë sjellin letërsinë e lëvruar dhe më të përpunuar në shije, e dominojnë opinionin publik me kulturën shqiptare, duke zhvilluar tek publiku vetëdijësim. Përmes rubrikave të kritikës letrare ato frymëzojnë lëvizje të shkrimtarët.

Nuk mungojnë sidomos në shtypin e pas ‘90-ës, tekste letrare me cilësi të ndryshme, duke përfshirë këtu dhe autorë të panjohur. Qëllimi kryesor ka të bëjë me sjelljen e sa më shumë autorëve me përmbajtje të pasur letrare. Letërsia që promovohet synon të arrijë publikun e vet. Këto periodikë prezantojnë letërsinë shqipe sipas llojeve letrare (poezi, prozë, dramë); prezantojnë profile autorësh të njohur të sprovuar me lexuesin, si dhe autorë të rinj; publikojnë intervista me autorë si perspektivë e procesit krijues; organizojnë platforma për zbulimin e autorëve të rinj.

Së fundmi, prania e letërsisë shqipe në shtypin e shkruar është shtrirë edhe me mjetet e komunikimit online, duke u mundësuar shkrimtarëve shqiptarë të arrijnë një audiencë më të gjerë dhe t’i bëjnë veprat e tyre të njohura përtej kontekstit letrar tradicional.

Referencat

- [1]. Boriçi, Hamit (1999). “Fillimet e gazetarisë shqiptare dhe periodizimi i historisë së saj”, Media Shqiptare, AMI, IREX, SOROS, Tiranë, janar mars 1999, f. 97-121.
- [2]. Çika, Nebil (1935). Erdh Koha jonë por..., Revista “Minerva”, Tiranë, 6.
- [3]. Koliqi, Ernest (1957), Shejzat” (Le Pleiadi), Vëll. 1. Nr. 1, f. 2.
- [4]. Koliqi, Ernest (1940). “Shkëndija”. 1/1940. nr. 1. f. 6.
- [5]. Kruja, Mustafa, te “Shkëndija”. 1/1940. nr. 1. f. 8.

- [6]. Merxhani, Branko (1936). “Përpyjekja Shqiptare”, revistë e përmuajshme kulturale. Viti 1, Tiranë, tetor, nr. 1. f.3.
- [7]. Ndreca Ardian (2016). “Shejzat”, Pleiades, Viti 1, Janar – Qershor 2016, 1-2. Parathënie. f. 3.
- [8]. Pipa, Arshi. (1944) “Kritikë”, Numri i muajit Mars, f. 26.